

Dr. Rovena (Vata) MIKELI

**NJOHJA E ATË GJERGJ FISHTËS NË ARKIVIN E INSTITUTIT
TË GJUHËSISË DHE LETËRSISË PRANË AKADEMISË SË
STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TIRANË**

Përmbledhje

Atë Gjergj Fishta, personaliteti më i rëndësishëm jo vetëm i letërsisë në veçanti, por edhe i historisë kombëtare në përgjithësi, i njohur si “Homeri shqiptar”, është shkrimtari i letërsisë shqipe që lëvroi disa aspekte të rëndësishme të saj.

Atë Gjergj Fishtën pa mëdyshje mund ta quajmë ‘arkeolog’ të fjalës shqipe, pasi çdo fjalë e shkruar nga ai është përdorur në vendin e duhur, në momentin e duhur dhe në kohën e duhur. Fjala fishtjane është aktuale edhe sot e kësaj dite në realitetin që jetojmë dhe përjetojmë. Mbase sot fjalët e tij janë edhe më aktuale sesa në kohën kur ai i la të shkruara!

Duke iu referuar thirrjes për pjesëmarrje dhe temës bosht, menduam që në këtë paraqitje të referohemi në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë, për të marrë në shqyrtim se cilat janë avantazhet që sjell ky arkiv në lidhje me këtë personalitet të letrave shqipe.

Dosjet për Atë Gjergj Fishtën nuk janë të pakta. Aspekti letrar është trajtuar më së shumti nga studiues dhe njohës të mirë të veprës dhe imazhit fishtjan, por janë të arkivuara në dosje të veçanta edhe dorëshkrimet e tij. Në dokumentet arkivore pranë IGJL-së trajtoheshin disa tema delikate dhe të shumëfishta lidhur me mendimin e Atë Fishtës, siç ishin çështjet e teorisë së metrikës shqipe. Atë Gjergj Fishta kryeveprën e tij *Lahuta e Malcís* e shkroi në vargun popullor dhe kombëtar, duke përdorur tetërrokëshin, e quajtur nga vetë Atë Gjergj Fishta si pronë shpirtërore amtare.

Fjalët çelës: *Satira, 8 rrokëshi, metrika shqipe, dramaturgjia, historia kombëtare*

**INFORMATION ABOUT FATHER GJERGJ FISHTA,
ACCORDING TO THE DOCUMENTS PRESERVED AT THE
ARCHIVE OF THE INSTITUTE OF LINGUISTICS AND
LITERATURE OF THE ACADEMY OF ALBANOLOGICAL
STUDIES**

Abstract

Gjergj Fishta was a Franciscan friar, teacher, writer, translator, playwright, poet, chairman of the Commission for drafting the Albanian alphabet in the Congress of Manastir, member of Albanian delegation to the Paris Peace Conference on 1919, diplomat and envoy in the Balkan Conferences during the years '1930, etc.



Given the great poetic, cultural and political baggage of Fishta, whose works had been banned by communist dictatorship during 1945-1990 in Albania, this article aims to elaborate the role of archival data as evidence of cultural and historical heritage in relation to the content and management of Gjergj Fishta's archival fond.

By other words, the primary sources (manuscripts) deriving from his diplomatic activities, insights into world literature and literary translation, features of oral and aesthetic literature and aspects of musicology - are just some of many elements of the fond - and these elements will be elaborated from the perspective of their role in Albanian opinion and their impact on Albanian culture and history.

A special treatment will be given to the comparison of archive fond management during the communist period and the period after it, as well as the perspective of preserving and making available these materials to the Albanian public.

Keywords: *archives, management, literature, history, public opinion.*

Atë Gjergj Fishta një personalitet kompleks dhe shumë i rëndësishëm i letërsisë shqipe dhe jo vetëm. Dosja për Atë Gjergj Fishtën në arkivin e IGJL-së fillon me disa detaje të veprimtarisë së Atë Gjergj Fishtës ku, ndër të tjera, përmendet edhe misioni i tij i jetës, për t'i vënë marrëdhëniet diplomatike për herë të parë me ShBA-në në mënyrë zyrtare, ku shkruhet se Atë Gjergj Fishta në fillim të vitit 1922 shkoi në ShBA.



Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Në fillim të vitit 1922 ai vajti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Arsyet e këtij udhëtimi i shpjegon një bashkëpunëtor i tij. Pasi mori fund subvensioni austriak, Kuvendi Françeskan kërkoi burime të reja ndihme për veprimtarinë e vet fetare-politike.

Sipas bashkëpunëtorit në fjalë, Atë Fishta vajti në ShBA për t'u takuar me P. Gofredo Shilling, "nieri me auktoritet të pakufi në Washington" dhe për ta siguruar ndihmën prej tij, të cilin nuk arriti ta takonte. Shilling "ishte ndie tue folë për At Fishtën e këshilloi me bâ një udhëtim deri në Washington ku nderti At kishte ndëjen e vet si komisar i Tokës Shëjtë e kû kishte uzdajë se mund e përkrahte fort".

Dhe Atë Fishta i shkroi nga Uashingtoni një miku të vet: "Ndërkaq, vizita ime në Washtington par për rrjedhim njohjen e Shqipërisë nga ana e Shteteve të Bashkuara t' Amerikës. Të orvatjet e përparshme të Qeverisë sonë e të "Vatrës" patën mbetur pa përfundim. Unë ia dola... Kjo ndodhi nga ndërmjetësimi i Senatorëve katolikë, të cilëve ua pata paraqitur çështjen veçanërisht nga pikëpamja fetare, prandaj qeveria amerikane e njohu zyrtarisht Shqipërinë".

Një çështje e rëndësishme në dosjen për njohjen e Atë Gjergj Fishtës është trajtuar edhe çështja e përkthimit letrar ku, sipas tij, përkthimi i një vepre klasike ka analogji më të rënit e një melodie me vegla të ndryshme muzikore.

Sipas Atë Fishtës, folklori kishte një rëndësi të madhe për historinë kombëtare, për gjuhën dhe letërsinë, po ashtu. Atë Gjergj Fishta kishte trajtuar në mënyrë serioze dhe të detajuar edhe çështjen e burimit të poezisë gojore dhe të motiveve të saj.

Sipas tij, dy janë motivet e poezisë sonë gojore: trimëria dhe dashuria. Ndër motivet që e kanë tërhequr më shumë dhe të cilat kanë ndikuar herë pas here në krijimet e tij poetike janë: Gjergj Elez Alia, Halil Gërria, Tanusha etj. Pra të gjitha personazhet tipike të ndërtimit të Eposit të Kreshnikëve.

Gjatë hulumtimit në njohjen e Fishtës, sipas dosjeve të cilat gjenden në IGJL-në e ASA-së, vërejmë se kulmin e krijimeve të veta, e sidomos në llojin e satirës, ai e arriti me poemat *Palokë Cuca* në vitin 1922 dhe *Gomari i Babatasit* më 1923.

Një vlerësim i rëndësishëm i Gjergj Fishtës ishte edhe botëkuptimi i tij rreth artit të fjalës, ku vetë Fishta shprehej se "Pa bukuri nuk ka art", por që ishte i mendimit se bukuria është subjektive.

- 179 -

kështu mirënjohë. Tëra karakteristika kjo për vishën, i cili
 është përjetës nuk e munda aje ajo rënie dhe la emërtimit
 kësaj. Dhe të drama në subjekt anti, "Hijet e Parnasit" (1930),
 sektori tregoi tërësi për të cilin, ato të shprehura për shprehjen
 e shprehur, të shprehur në rolin e protagonistin, Ifigjenia, e cila
 la, në një vejë e urtë dhe sentimentale, kështu në një përjetësi
 të riakt. Në "Hijet e Parnasit" (1940) kemi një përjetësi
 në melodramatik në subjekt lirik përballor, në rolet e personazheve
 ve dala lulet në të bukura të natyrës. Jerina është personazhi
 i bukuri dhe i shpirtit të cilës të veshës shprehur.
 Vepër dramatik të vishës, të shkruara kryesisht midis m-
 rryes klasike, kanë tiparet e dramaturgjisë së kohës, në themel
 në sentimentalist, melodramatik dhe stilin retorik. Të shkruar
 në vënd, ato nuk përfiton në lartësinë e përjetësimit të ar-
 tit të pozit, po ruajnë vlerat e tyre dhe të veshës
 midis të cilave ato të teprimit të lehtësisë në të vjer-
 shësit. Ka në të personazhe të krijuara në shkëlqim dhe vërta-
 kështu jeta shpreh apo Ifigjenia, në bëhan rri për idetë; Alkibi,
 tregëtarit që anti Ifigjenia, shpreh në vj, për më qese në të ho-
 lis; Kithasë, dhe e dëshamur; personazhi përballor i Jerinës.
 Në shprehur edhe shpreh interesante dhe shpreh dramatik të kri-
 juara shpreh. Shpreh sektori dhe një kontribut të mirë për kohën në
 krijimin e dramaturgjisë së kohës. Në të shprehur në vënd, në një për-
 jetësi e shprehur komedit "Hijet e Parnasit", "Hijet e
 Shprehur", "Hijet e Parnasit" dhe "Hijet e Parnasit".
 Shprehur në talent të rregulluar, vishës
 i këndoi shprehur shprehur, shprehur
 shprehur, evokoi të shprehur e vëndit.
 pasqyroj vishës lartës e shprehurve kundër shprehurit malës

DOSJE Nr. Viti

Titulli i dosjes

gj. Fishta. Chop. i letësisë të letësisë



Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Në këto dokumente zbulohet se Atë Fishta kishte mendime që bëjnë fjalë për artin në përgjithësi dhe letërsinë në veçanti, mendime dhe vlerësime për letërsinë botërore dhe letërsinë gojore, për gjuhën letrare shqipe dhe përkthimin artistik. Arti, sipas Atë Fishtës, ka mision të riprodhojë.

Në dosjen për njohjen e Atë Fishtës gjejmë të botuar edhe artikullin "Hijet e Parnasit", në të cilin Atë Fishta shtjellonte raportin që kishin faktet negative me faktet pozitive ku, sipas tij, artisti, që të arrijë ta pasqyrojë historinë kombëtare, duhet t'i zgjedhë ato fakte që janë pozitive.



Atë Gjergj Fishta është një nga personalitetet më komplekse të letërsisë shqipe qoftë nga veprimtaria politike, shoqërore dhe kulturore, qoftë edhe nga ideologjia drejtuese e pikëpamjet estetike, qoftë edhe nga krijimtaria publicistike dhe ajo letrare.

Krijimtarinë letrare të Atë Gjergj Fishtës, historia e letërsisë e shih në lidhje të ngushtë me historinë politike e të mendimit dhe me historinë e gjuhës, e zhvilluar në një kohë të gjatë plot ngjarje, ndeshje e kthesa historike të popullit shqiptar.





Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Atë Fishta është nga ata autorë që bëjnë kalimin nga periudha e Rilindjes në periudhën e Pavarësisë jo vetëm me tematikën, por edhe me metodën artistike.



Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Tek Atë Fishta hasën tri metoda artistike: klasicizmi, romantizmi dhe realizmi, pasi vepra e tij *Lahuta e Malcís* edhe pse në pjesën e saj më të madhe u krijua pas Rilindjes, nga tematika i përket Rilindjes, kurse *Palokë Cuca* dhe *Gomari i Babatasit* edhe u krijuan gjatë periudhës së pavarësisë, edhe nga ana tematike i përkasin kësaj periudhe.



Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Në dosje theksohet edhe fakti se në moshën 23 vjeçe Atë Fishta ishte një ndër nismëtarët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të shoqërisë *Bashkimi*, e cila u themelua në fillim të vitit 1899 dhe që caktoi përdorimin e alfabetit me po atë emër, me të cilën u botuan edhe libra të shumtë. Atë Fishta u dallua si askush tjetër si një talent i ri i patakuar më parë në dialektin gegë.



Në vitin 1907 zu fill veprimtaria e teatrit françeskan, që u krijua nga Atë Fishta, i cili, në vitin 1902, punoi si drejtor i shkollës françeskane, e themeluar me ndihmën e Austro-Hungarisë që në vitin 1861, por që drejtohej nga klerikë të huaj.

Ardhja e Atë Fishtës në krye të kësaj shkolle ishte në dobi të këndimshkrimit shqip, sepse ai futi shqipen si gjuhë mësimi, e zgjeroi dhe e rriti shkollën me klasë dhe lëndë diturake.

Në atë kohë, në krahasim me shkollat e huaja si ajo turke, greke, italiane dhe serbe, “shkolla e Pater Gjergjit” luajti një rol pozitiv por, më vonë, në kushtet kur u bë e mundur, që të gjitha shkollat fetare të vendit të laikizohen, ajo nuk mundi më të luante rolin pozitiv që kishte më parë.

Në dosje vihet theksi se Atë Fishta punoi për çështjen e drejtë të gjuhës, letërsisë dhe shkollave shqipe, bëri thirrje për bashkim kombëtar pa dallim feje dhe krahine, mburri lashtësinë e luftërat për liri të popullit shqiptar, denoncoi pa mëshirë plagë të shoqërisë shqiptare të kohës, shkelësit turq dhe shovinistë serbo-malazezë, italianë, grekë. Më 1921 Shkolla Françeskane që drejtohte Fishta u bë lice. Këtë vit, pas një ndërprerjeje mjaft të gjatë, zu të ribotohet revista *Hylli i Dritës*, përsëri nën drejtimin e tij.

Atë Fishta që në fillim të krijimtarisë e shfaqti veten poet me një rremb satirik të fuqishëm dhe original. Shkrimet e tij të para në satirë qenë vjershat *Z. Anselmo Lorecch n’Vjenë, Dreqnit e Don Dreut’, Makeroniana, Jaho Begu e Palok Cuca*, ku me një ironi të hollë qesëndisi përpjekjet e imperialistëve italianë për ta futur Shqipërinë në sferën e ndikimit të vet.



Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Në satirat me motiv patriotik të Atë Fishtës hyjnë një tok vjershash të gjata të shkruara në kohë të ndryshme. Të gjitha këto janë krijime shumë të bukura ku, përveç talentit satirik që shndrit aty plot ngjyra të ndryshme, u shfaq edhe fantazia e shkathtë e poetit përmes situatave komike dhe thurjeve nga më origjinalet.

- 151 -

dhe ato në gjatë të huaj.

Veptrat satirike kryesore të Fishtës janë "Falokë Cucës" (1922) dhe "Gomari i Babatasit" (1923), e para botuar në "Aksat e Farnesit" (në bot. 2), kurse e dyta në vaktë.

Te "Falokë Cucës", poeti ka për qëllim të paragojë shkollën e huaj si role të propagandës antikomuniste dhe të tregojë fytyrën e përmasuar të asaj pjese të borgjezisë shkodrane, që, e shantistur nga fjalët e shpalljeve fetare italiane, arrinte gjër të mendojë atëherë dhe kombësinë e vet.

Veptra është ndërtuar në llojin e tregimit poetik. Duke marrë shikim nga një ngjarje e thjeshtë, autori shtjellon mendime, koment, ironinë e tall mendësinë, parashikimet, zakonet dhe lakmitë e tregtarëve kompromitë të çybetit të veriut. Që në krye, si na tregon të kaluarën e njërit prej personazheve, Filipit, i cili rritte nga një baba shumë i pasur, që e kishte fituar mallin e gjunës "Ene vretun me Fander e me taffer", po bënte jetë çeni. Si i vdiqen prindët, Filipi e dha mbesë bijën e kuzarit. Sadoqë ra nga vakti, ai prapë donte të mbeshej "tashpër". Du të byjë në borxhe, po shëndaje e tij h keqësin e dha në tepër pesë u marrua me Danin, grua mëndjehetë. Midis atij dhe të shqoqes pleai grindja, sepse Dani donte t'i vejë të birat e tër italian dhe pastaj ta çonte në shkollë italiane, ndërsa Filipit i bë maki i pelqeu. Përmas fjalëve të këtij, poeti ve në lojë ata shqipëtarë që ishin verbuar nga propagandat e huaja dhe përëndonin pas gjithëkujde që vinte nga jashtë.

U vdo kurbal e kran, q' t'qesë këdeq deti,
U profesor e mbsi e mbi krye t'bi
U bani be, u'r te mendue me vakti...
Ue shke se haj'a na e k'w', qysh se në krye
s'ua hi, se t'huajt janë krajt si kaganiili,
q' kahdo t'biqjës, shkojnë vendin tuq e zhye.

- 151 -

dhe ato në gjatë të huaj.

Veptrat satirike kryesore të Fishtës janë "Falokë Cucës" (1922) dhe "Gomari i Babatasit" (1923), e para botuar në "Aksat e Farnesit" (në bot. 2), kurse e dyta në vaktë.

Te "Falokë Cucës", poeti ka për qëllim të paragojë shkollën e huaj si role të propagandës antikomuniste dhe të tregojë fytyrën e përmasuar të asaj pjese të borgjezisë shkodrane, që, e shantistur nga fjalët e shpalljeve fetare italiane, arrinte gjër të mendojë atëherë dhe kombësinë e vet.



Veptra është ndërtuar në llojin e tregimit poetik. Duke marrë shikim nga një ngjarje e thjeshtë, autori shtjellon mendime, koment, ironinë e tall mendësinë, parashikimet, zakonet dhe lakmitë e tregtarëve kompromitë të çybetit të veriut. Që në krye, si na tregon të kaluarën e njërit prej personazheve, Filipit, i cili rritte nga një baba shumë i pasur, që e kishte fituar mallin e gjunës "Ene vretun me Fander e me taffer", po bënte jetë çeni. Si i vdiqen prindët, Filipi e dha mbesë bijën e kuzarit. Sadoqë ra nga vakti, ai prapë donte të mbeshej "tashpër". Du të byjë në borxhe, po shëndaje e tij h keqësin e dha në tepër pesë u marrua me Danin, grua mëndjehetë. Midis atij dhe të shqoqes pleai grindja, sepse Dani donte t'i vejë të birat e tër italian dhe pastaj ta çonte në shkollë italiane, ndërsa Filipit i bë maki i pelqeu. Përmas fjalëve të këtij, poeti ve në lojë ata shqipëtarë që ishin verbuar nga propagandat e huaja dhe përëndonin pas gjithëkujde që vinte nga jashtë.

U vdo kurbal e kran, q' t'qesë këdeq deti,
U profesor e mbsi e mbi krye t'bi
U bani be, u'r te mendue me vakti...
Ue shke se haj'a na e k'w', qysh se në krye
s'ua hi, se t'huajt janë krajt si kaganiili,
q' kahdo t'biqjës, shkojnë vendin tuq e zhye.

Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)



Një motiv tjetër me rëndësi i satirës së Atë Fishtës është edhe ai i jetës politike ndërkombëtare, i cili gjeti pasqyrim te vjershat *Lumi i Forti*, *Jus gentium* dhe *Tatari i diplomacisë*. Në këto krijime me një satirë therëse denonconte synimet grabitqare të shovinistëve grekë, serbë, malazezë dhe bullgarë, të cilat poeti i quan “dreqen Kojshi”.

Anazat e Parnasit që një hap tutje i poetit në rrugën e satirës. Pos tematikës, e cila u zgjerua mjaft, libri dëshmon se poeti kishte fituar pjekuri estetikë, sa të përdorë në mënyrë krijuese folklorike.



Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Vepra është një përmbledhje vjershash të forta satirike me temë politike dhe politiko-shoqërore. Autori i prek bashkatdhetarët në sedër dhe i qorton ashpër, se vijojnë të jenë të përcarë dhe pasivë në lëvizjen patriotike.



Atë Gjergj Fishta në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (ASA)

Duke u veshur figurativisht me tiparet morale negative të një shqiptari, që ka mohuar atdhetarë dhe pranon të quhet gjithçka, veç jo shqiptar, te *Metamorphosis* Atë Fishta godet me zemërim të thellë dhe sarkazëm anti-patriotët, njerëzit me njëqind faqe e pa parime politike, të pasurit e rreshqerët, që janë mbledhur në guaskën e egoizmit të tyre e nuk trazohen fare për çështjet e Shqipërisë.

*T'a dijë Shqypnija
Pra, e sheklli mbarë
Se ma mbas sodit,
Un s'jam Shqiptar.*

Kurse në poemthin *Bujari* (1907) poeti dënon mentalitetin e oxhakësisë dhe ambiciet e klasës së pasur. Ai fishkëllon me tallje dhe përbuzje ata të rinj nga shtresat e larta që kthehen nga jashtë të prishur prej veseve të shoqërisë së atjeshme dhe sjellin me vete të liga të reja në shoqërinë e vendit. Por satira është e njëanshme, sepse jo çdo i ri që kthehej nga jashtë mund të bëhej objekt i një kritike të tillë.

Duke rrëfyer te poezia *Nakdonicipadia* (1907) një histori fantastike me personazhe biblike, ku një herë perëndia kishte urdhëruar Shën Nikollën t'u shesë edhe ca tru më tepër njerëzve, sepse treqind derhem nuk po u mjaftuakan, Atë Fishta kritikon ashpër indiferentizmin e shqiptarëve ndaj çështjes kombëtare dhe diturisë, lakminë e tyre për pasuri.

Në poezinë *Dredha e Djallit* (1908) tregohet për Shën Mehillin e Shën Pjetrin, që zbritën në tokë e me një lëmsh peri ndaj mëndafshi, zunë mesin e botës anembanë. Kur erdhën në Shqipëri peri iu mbarua. Bënë ç'bënë, më në fund thirrën Djallin, ia rropën lëkurën dhe si e drodhën, zunë t'i matin me të kufijtë e Shqipërisë.

Që këtej, thotë poeti, erdhën grindjet dhe mosmarrëveshjet, që po i sjellin dëm të madh vendit. Në *Anzat e Parnasit* një vend shumë të rëndësishëm zënë vjershat që u kushtohen dredhive dhe intrigave, që kurdisin shtetet e huaja për të ndarë në mes të tyre Shqipërinë.

Atë Fishta dënon ashpër synimet graditqare të shovinistëve grekë, serbë, malazezë e bullgarë, të cilët i quan "dreqen kojshi". Në këtë kohë i shkruan disa satira kundër fuqive kolonialiste të Evropës dhe veçanërisht kundër kolonializmit anglez, që për t'i shtuar pasuritë e veta, shtyu dhe shfarosi popujt e vegjël dhe të pambrojtur. Në *Jus Gentium* me zemërim flitet për ndërhyrjen dhe barbarizmat imperialiste të kryera në Kinë dhe shfaqet simpatia për popullin e zgjuar, punëtor, të ditur e trim kinez.

Përkrahja e luftës së popujve të shtypur për liri ka gjetur shprehje edhe në krijime të tjera, si në tingëllimin *Lumi i fortë*, ashtu sikurse Çajup poeti që demaskon kolonializmin anglez dhe shpreh ndjenjën e solidaritetit të

një populli të vogël të shtypur ndaj një populli tjetër të vogël me të njëjtin fat.

Në prag të luftës ballkanike dhe të pavarësisë së vendit, më 1911, Fishta shkroi poezinë e fuqishme satirike *Tatari i Diplomacisë*, e cila doli në dritë pas 31 vjetësh. Arsyeya, duket, qëndron në faktin se aty poeti vë në lojë shumë rëndë dorinë austriake, tek e cila gjer më 1918 gjente mbështetje dhe mbrojtje kleri katolik.

Poezia është hartuar në trajtën e një letërkëmbimi në vargje tetërokëshe midis kancelarit Aerenthal dhe Sadrazenit Haki Pasha. Nën titullin është vënë thënia shumë denoncuese për të dyja palët: *Ait latro ad latronem*. Nga letrat që i shkruajnë njeri-tjetrit të dy personalitetet politike, del qartë se perandoritë austro-hungareze dhe otomane janë bërë miq nga halli.

Përfundim

Atë Gjergj Fishta pa mëdyshje mund të quhet ‘arkeolog’ i fjalës shqipe, pasi çdo fjalë e shkruar nga ai është përdorur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, por Fishta shkonte deri në zbulimin e thellësisë së fjalës artistike, historike, filozofike, kulturore etj., duke i dhënë të gjitha kuptimet e saj të mundshme në kohën që jetoi, të tilla kuptime që sot janë më aktuale se kurrë, sidomos në sferën intelektuale dhe atë politike.

Në këtë punim hulumtuam rreth njohjes së Atë Gjergj Fishtës përmes fondit që ndodhet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë (pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë), iu referuam dosjeve që i përkasin këtij personaliteti të rëndësishëm për Shqipërinë dhe shqiptarët, ku të dhënat arkivore shërbejnë si dëshmi e njohjes së figurës së tij në të gjitha sferat që Atë Fishta lëvroi.

Atë Gjergj Fishta është shkrimtari i letërsisë, i historisë dhe kulturës shqiptare që lëvroi disa aspekte të rëndësishme në letërsinë shqipe. Dosja e Atë Gjergj Fishtës në këtë arkiv fillon me disa detaje të veprimtarisë së tij ku, ndër të tjera, përmendet edhe misioni i jetës së vet, për t’i vënë marrëdhëniet diplomatike për herë të parë, në mënyrë zyrtare me ShBA-në në vitin 1922. Viti 2022 përkon me 100-vjetorin e këtyre marrëdhënieve diplomatike zyrtare, të cilat mbajnë emrin dhe firmën fishtjane.

Në fondin e Atë Gjergj Fishtës trajtohen tema delikate dhe të shumëfishta lidhur me mendimin e Atë Fishtës, siç ishin çështjet e teorisë së metrikës shqipe. Si dëshmi për njohjen fishtjane në këtë arkiv është edhe dorëshkrimi i kryeveprës së tij *Lahuta e Malcís*, e shkruar nga Atë Fishta në vargun popullor dhe kombëtar, duke përdorur tetërokëshin, e quajtur nga vetë Atë Fishta si pronë shpirtërore amtare. Gjithashtu, me tetërokëshin janë krijuar edhe këngët kreshnike shqipe. Atë Gjergj Fishta e trajton tetërokëshin si një metër që ndërtohet mbi bazën e natyrës së shqipes.

Një tjetër çështje e rëndësishme si pjesë e trashëgimisë kulturore në këtë arkiv është edhe trajtimi i çështjes së përkthimit letrar ku, sipas tij, përkthimi i një vepre klasike ka analogji më të rënit e një melodie me vegla të ndryshme muzikore. Gjithashtu, si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe kujtesës historike, sipas Atë Gjergj Fishtës, është edhe folklori, i cili kishte një rëndësi të madhe për historinë kombëtare, për gjuhën dhe letërsinë shqipe.

Në këtë arkiv gjejmë të dhëna që Atë Fishta kishte trajtuar në mënyrë serioze dhe të detajuar edhe çështjen e burimit të poezisë gojore dhe të motiveve të saj. Sipas tij, dy janë motivet e poezisë sonë gojore: trimëria dhe dashuria. Ndër motivet që e kanë tërhequr më shumë dhe të cilat kanë ndikuar në krijimet e tij poetike janë: Gjergj Elez Alia, Halil Gërria dhe Tanusha. Të gjitha personazhe tipike të ndërtimit të eposit të kreshnikëve.

Atë Gjergj Fishta kulmin e krijimit të tij, sidomos në llojin e satirës, e arriti me poemat *Palokë Cuca* në vitin 1922 dhe *Gomari i Babatasit* më 1923. Një vlerësim i rëndësishëm i Gjergj Fishtës në këtë arkiv ishte edhe mendimi i tij për artin në përgjithësi dhe letërsinë në veçanti, mendime dhe vlerësime për letërsinë botërore dhe letërsinë gojore, për gjuhën letrare shqipe dhe përkthimin artistik. Arti, sipas Atë Fishtës, ka mision të riprodhojë.

Atë Gjergj Fishta në këto dokumente del si një nga personalitetet më të rëndësishme dhe komplekse të historisë dhe kulturës shqiptare, si nga veprimtaria politike, shoqërore dhe ajo kulturore, si nga ideologjia drejtuese dhe pikëpamjet estetike, por edhe nga krijimtaria publicistike dhe letrare. Krijimtarinë letrare të Atë Gjergj Fishtës historia e letërsisë e sheh në lidhje të ngushtë me historinë e mendimit politik dhe me historinë e gjuhës.

Për sa i takon kujtesës dhe burimeve historike në këtë arkiv thuhet se Atë Fishta që në moshën 23-vjeçare ishte një ndër nismëtarët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të shoqërisë *Bashkimi* që u themelua në fillim të vitit 1899 dhe që caktoi përdorimin e alfabetit me po atë emër, me të cilën u botuan edhe libra të shumtë. Atë Fishta u dallua si askush tjetër si një talent i ri i patakuar më parë në dialektin gegë.

Më 1907 zu fill veprimtaria e teatrit françeskan, që u krijua nga Atë Fishta, i cili, gjithashtu, që më 1902 punoi si drejtor i shkollës françeskane, themeluar me ndihmën e Austro-Hungarisë që më 1861.

Ardhja e Atë Fishtës në krye të kësaj shkolle ishte në dobi të këndimit dhe shkrimit shqip, sepse ai futi shqipen si gjuhë mësimi. Në atë kohë, në krahasim me shkollat e huaja si ajo turke, greke, italiane dhe serbe, “shkolla e Pater Gjergjit” luajti rol pozitiv. Jehona e saj edhe sot është e freskët dhe shërben si model frymëzimi.

Literatura:

Arkivi i Institutit i Gjuhësisë dhe Letërsisë (Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë), dosjet për Atë Gjergj Fishtën, I, II, III, IV, V, VI, VII.